

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Menaxhimi i Performancës

P8

Nr.

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Data
Date

20.02.2021

CONTENT / PËRMBAJTJA

SESSION	MAXIMUM ASSIGNED	-ATTENTION! THIS PART IS FOR SCAAK USE ONLY- MARKS AWARDED
1. Problem 1	20	
2. Problem 2	20	
3. Problem 3	20	
4. Problem 4a	12	
4b	8	
5. Problem 5	20	
Total	100	

Pjesa	Maksimumi i dhënë	-Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga ShKÇAK- PIKËT E DHËNA
1. Problemi 1	20	
2. Problemi 2	20	
3. Problemi 3	20	
4. Problemi 4a	12	
4b	8	
5. Problemi 5	20	
Total	100	

Problemi 1

Kompania Sport-AS prodhon një gamë të gjerë të rekuizitave sportive. Linja për prodhimin e topave të vëllimit të madh prodhon 4 lloje të topave. Topa W për Water-polo, topat V për Volleyball, topat F për Football dhe topat B për Basketball. Të dhënat për prodhimin dhe kostot për periudhën e sapo përfunduar janë si më poshtë.

	<i>Njësi të prodhuara (copë)</i>	<i>Numri i ngasjeve të prodhimitarisë për periudhën</i>	<i>Kosto e materialeve për njësi (€)</i>	<i>Orët e punës direkte për njësi</i>	<i>Orë të makinerisë për njësi</i>
W - Water polo	5,000	2	3	2	1
V - Volleyball	5,000	2	15	4	3
F - Football	50,000	8	3	2	1
B - Basketball	50,000	<u>8</u>	15	4	3
		20			

Kosto e punës direkte për orë: €6.00

Shpenzimet e përgjithshme të prodhimitarisë:

Kosto variabile afat-shkurtra	€110,000
Kostot e organizimit	€218,400
Kostot e përshejtimit dhe planifikimit	€182,000
Kostot e trajtimit të materialeve	€149,600

Faktori nxitës

Orët e makinerisë
Numri i ngasjeve
Numri i ngasjeve
Numri i ngasjeve

Kërkohet

- Përgatitni koston për njësi për çdo produkt duke përdorur
 - koston konvencionale përvetësuese, **6 pikë**
 - koston e bazuar në veprimtari (ABC). **8 pikë**
- Përgatitni tabelën përmbledhëse të rezultateve nga kërkesa a.i. dhe a.ii. duke llogaritur ndryshimin për njësi, ndryshimin total të secilit produkt dhe ndryshimin e përgjithshëm të totaleve të tyre. **4 pikë**
- Tregoni se cila metodë të shpërndarjes së ShPP-së (sipas mendimit tuaj) është më e drejtë duke e arsyetuar mendimin e dhënë. **2 pikë**

Zgjidhja

- Llogaritja e koston për njësi për çdo produkt
 - Sipas koston konvencionale përvetësuese

Shpenzimet e përgjithshme të prodhimitarisë

Kosto variabile afat-shkurtra	€110,000
Kostot e organizimit	218,400
Kostot e përshejtimit dhe planifikimit	182,000
Kostot e trajtimit të materialeve	<u>149,600</u>
	660,000

0.5 pikë

<u>Numri i orëve të makinerisë</u>		<u>Orë të makinerisë</u>	<u>Orët totale të makinerisë</u>	
<u>Produkti</u>	<u>Njësi</u>	<u>për njësi</u>		
W - Water polo	5,000	1	5,000	
V - Volleyball	5,000	3	15,000	
F - Football	50,000	1	50,000	
B - Basketball	50,000	3	<u>150,000</u>	
	Totali i orëve të makinerisë		220,000	0.5 pikë

Llogaritja e normës së përvetësimit të SHPP-së

Formula: Norma e përvetësimit të ShPP-së = ShPP e vlerësuar ÷ numri i vlerësuar i orëve të makinerisë
= €660,000 ÷ 220,000 orë të makinerisë
= **€3.00** për orë të makinerisë **1 pikë**

<u>Llogaritja e koston për njësi</u>	<u>W</u>	<u>V</u>	<u>F</u>	<u>B</u>	
Materialet e drejtpërdrejta	15,000	75,000	150,000	750,000	
Puna e drejtpërdrejtë	60,000	120,000	600,000	1,200,000	
<u>ShPP (LI1)</u>	<u>15,000</u>	<u>45,000</u>	<u>150,000</u>	<u>450,000</u>	2 pikë
Kosto e totale e prodhimit	90,000	240,000	900,000	2,400,000	1 pikë
Njësi të prodhuara	÷ 5,000	÷ 5,000	÷ 50,000	÷ 50,000	
Kostoja për njësi	18.00	48.00	18.00	48.00	1 pikë

<u>LI1 - Llogaritjet</u>		<u>Orë të makinerisë</u>	<u>Norma e përvetësimit</u>	<u>Vlera e</u>
<u>Produkti</u>	<u>Njësi</u>	<u>për njësi</u>	<u>të ShPP-së (€/orë)</u>	<u>ShPP-së</u>
W - Water polo	5,000	1	3.00	15,000
V - Volleyball	5,000	3	3.00	45,000
F - Football	50,000	1	3.00	150,000
B - Basketball	50,000	3	3.00	<u>450,000</u>

ii. koston e bazuar në veprimtari (ABC).

<u>Norma e përvetësimit për:</u>	<u>Faktori nxitës (FN)</u>	<u>Kosto</u>	<u>Njësi të FN</u>	<u>Norma e veprimtarisë</u>
Kosto variabile afat-shkurtra	orë pune të makinerisë	110,000	220,000	€0.50
Kostot e organizimit	ngasje të prodhimtarisë	218,400	20	€10,920.00
Kostot e përsheptimit dhe planifikimit	ngasje të prodhimtarisë	182,000	20	€9,100.00
Kostot e trajtimit të materialeve	ngasje të prodhimtarisë	149,600	20	€7,480.00
				4 x 0.5 = 2 pikë

Llogaritja e koston për njësi

	<u>W</u>	<u>V</u>	<u>F</u>	<u>B</u>	
Materialet e drejtpërdrejta	15,000	75,000	150,000	750,000	
Puna e drejtpërdrejtë	60,000	120,000	600,000	1,200,000	
<u>Kosto variabile afat-shkurtra (LI2)</u>	<u>2,500</u>	<u>7,500</u>	<u>25,000</u>	<u>75,000</u>	1 pikë
<u>Kostot e organizimit (LI3)</u>	<u>21,840</u>	<u>21,840</u>	<u>87,360</u>	<u>87,360</u>	1 pikë
<u>Kostot e përsheptimit dhe planifikimit (LI4)</u>	<u>18,200</u>	<u>18,200</u>	<u>72,800</u>	<u>72,800</u>	1 pikë
<u>Kostot e zhvendosjes të materialeve (LI5)</u>	<u>14,960</u>	<u>14,960</u>	<u>59,840</u>	<u>59,840</u>	1 pikë
Kosto e totale e prodhimit	132,500	257,500	995,000	2,245,000	1 pikë
Njësi të prodhuara	<u>5,000</u>	<u>5,000</u>	<u>50,000</u>	<u>50,000</u>	
Kostoja për njësi	€26.50	€51.50	€19.90	€44.90	1 pikë

L12 - Llogaritjet

<u>Produkti</u>	<u>Njësi</u>	<u>Kosto variabile afat-shkurtra</u>		
		<u>Orë të makinerisë</u>	<u>Norma e veprimtarisë</u>	<u>Vlera e ShPP-së</u>
W - Water polo	5,000	1	0.50	2,500
V - Volleyball	5,000	3	0.50	7,500
F - Football	50,000	1	0.50	25,000
B - Basketball	50,000	3	0.50	75,000

L13 - Llogaritjet

<u>Produkti</u>	<u>Numri i ngasjeve</u>	<u>Kostot e organizimit</u>	
		<u>Norma e veprimtarisë</u>	<u>Vlera e ShPP-së</u>
W - Water polo	2	10,920	21,840
V - Volleyball	2	10,920	21,840
F - Football	8	10,920	87,360
B - Basketball	8	10,920	87,360

L14 - Llogaritjet

<u>Produkti</u>	<u>Numri i ngasjeve</u>	<u>Kostot e përshejtimit dhe planifikimit</u>	
		<u>Norma e veprimtarisë</u>	<u>Vlera e ShPP-së</u>
W - Water polo	2	9,100	18,200
V - Volleyball	2	9,100	18,200
F - Football	8	9,100	72,800
B - Basketball	8	9,100	72,800

L15 - Llogaritjet

<u>Produkti</u>	<u>Numri i ngasjeve</u>	<u>Kostot e zhvendosjes të materialeve</u>	
		<u>Norma e veprimtarisë</u>	<u>Vlera e ShPP-së</u>
W - Water polo	2	7,480	18,200
V - Volleyball	2	7,480	18,200
F - Football	8	7,480	72,800
B - Basketball	8	7,480	72,800

b. Tabela përmbledhëse e rezultateve

<u>Produkti</u>	<u>Kostoja sipas kostos konvencionale</u>	<u>Kosto sipas ABC</u>	<u>Ndryshimi për njësi</u>	<u>Ndryshimi në total sipas produkteve</u>
W	18.00	26.50	8.50	42,500.00
V	48.00	51.50	3.50	17,500.00
F	18.00	19.90	1.90	95,000.00
B	48.00	44.90	-3.10	-155,000.00
		Ndryshimi i përgjithshëm		0.00

4 pikë**c. Metoda më e drejtë e shpërndarjes së ShPP-së**

Nisur nga aspekti teorik dhe mbështetur nga kalkulimet e bëra më lartë mund të konkludohet se sistemi konvencional i koston përvetësuese i bazuar në sasinë e njërive të prodhuara (vëllimin e prodhimit) është me të meta, sepse produktet me numër të vogël të njërive Topat W (për Water polo) dhe Topat V (për Volleyball) nuk janë ngarkuar me një 'ndarje të drejtë' të shpenzimeve të përgjithshme të veprimtarive mbështetëse pasi që ndarja është bërë bazuar në vetëm në një faktor nxitës në këtë rast orët e punës së makinerisë, faktor ky që nxitë koston më të ultë të ShPP-së (vetëm €110,000) krahasuar me veprimtaritë tjera.

Duke i identifikuar faktorët nxitës të cilët i shkaktojnë koston në veprimtaritë e ndryshme dhe duke bërë ndarjen e kostove bazuar në secilin shkaktarë për veprimtarinë përkatëse padyshim se 'prodhohet' një kosto më 'reale' ose më 'të kënaqshme', proces i cili realizohet përmes ABC (Koston së bazuar në veprimtari). **2 pikë**

Problemi 2

Kompania F prodhon dhe shet dy produkte, A dhe B, dhe secili prej tyre kalon përmes operacioneve të njëjta të procesit të automatizuar të prodhimit. Të dhënat e vlerësuara në vijim janë në dispozicion për periudhën 1.

▪ Të dhënat e produktit për njësi

	<u>Produkti A</u>	<u>Produkti B</u>
Kostoja e materialit direkt (€)	12	80
ShPP variabile (€)	58	16
Orët e përgjithshme për njësi të produktit (orë)	2.5	1.5

- Vlerësimet origjinale të prodhimitarisë/shitjes së produkteve A dhe B janë 6,000 njësi dhe 4,000 njësi respektivisht. Çmimet e shitjes për njësi për Produktin A dhe Produktin B janë €200 dhe €220 respektivisht.
- Kërkesa maksimale për çdo produkt është 25% mbi nivelet e vlerësuara të shitjes.
- Gjithsej shpenzimet e përgjithshme fikse e prodhimitarisë janë në vlerë prej €980,000. Kjo është shuma e përvetësuar nga produktet A dhe B me një normë mesatare për orë të bazuar në nivelet e vlerësuara të prodhimitarisë.

Një prej operacioneve të prodhimitarisë ka një kapacitet maksimal prej 5,500 orëve, operacioni i cili është identifikuar si 'fyt i ngushtë' që kufizon prodhimitarinë/shitjen e përgjithshme të produkteve A dhe B. Orët për njësi të produktit të nevojshme për prodhimitarinë e produkteve A dhe B në operacionin e identifikuar si 'fyt i ngushtë' janë 0.5 dhe 0.4 respektivisht.

Kërkohet

- Llogaritni përzierjen (në njësi) të produkteve A dhe B, e cila do të bëjë maksimizimin e fitimit neto dhe vlerën (në €) të maksimizimit të fitimit neto bazuar në koston tradicionale përvetësuese. **7 pikë**
- Kompania F ka vendosur tashmë për të përcaktuar përzierjen e cila do të bëjë maksimizimin e fitimit të produkteve A dhe B në bazë të parimit të kontabilitetit të qarkullimit (xhiros) për të maksimizuar kthimin në qarkullim për orë të prodhimitarisë të burimit të 'fytit të ngushtë'. Duke pasur parasysh se shpenzimet e përgjithshme variabile, në bazë të vlerës (në €), e cila aplikohet në përzierjen origjinale të vlerësuar të prodhimitarisë/shitjes, tani konsiderohet të jetë fikse në afat të shkurtër/të ndërmjetëm:
 - Llogaritni përzierjen (e njësjive) të produkteve A dhe B, e cila do të bëjë maksimizimin e fitimit neto dhe vlerën e atij fitimi neto. **9 pikë**
 - Llogaritni koeficientin kontabël të qarkullimit të produkteve A dhe B dhe komentoni atë. **4 pikë**

Zgjidhja

a. Maksimizimi i fitimit neto bazuar në koston tradicionale përvetësuese

Përcaktimi i burimeve të pamjaftueshme, nëse ka ndonjë

Ne detyrë është e dhënë se një prej operacioneve të prodhimitarisë është 'fyt i ngushtë' i cili e bënë kufizimin e prodhimitarisë/shitjeve, dhe ai operacion ka një kapacitet maksimal prej **5,500** orëve. **1 pikë**

Renditja e produkteve mbi bazën e kontributit për njësi të faktor kufizues

	<u>Produkti A</u>	<u>Produkti B</u>	
Çmimi i shitjes	€200	€220	
Kostoja e materialit të drejtpërdrejtë	€12	€80	
ShPP variabile	+ €58	+ €16	
Totali i kostos variabile	- €70	- €96	
Kontributi për njësi	€130	€124	
Orë për njësi të 'fytit të ngushtë'	÷ 0.5	÷ 0.4	
Kontributi për orë të 'fytit të ngushtë'	€260	€310	
Renditja:	2	1	2 pikë

Përcaktimi i përzierjes së produkteve për maksimizimin e fitimit

<u>Prod.</u>	<u>Kërkesa</u>		<u>Orët e nevojshme</u>	<u>Orët në dispozicion</u>		<u>Njësi të prodhuara</u>
B	4,000 × 1.25 = 5,000	(× 0.4)	2,000	2,000	(÷ 0.4)	5,000
A	6,000 × 1.25 = 7,500	(× 0.5)	<u>3,750</u>	(Balanca) <u>3,500</u>	(÷ 0.5)	7,000
			5,750	5,500		2 pikë

Llogaritja e fitimit maksimal

<u>Produkti</u>	<u>Njësitë</u>	<u>Kontributi për njësi</u>	<u>Fitimi</u>
A	7,000	× €130	€910,000
B	5,000	× €124	+ €620,000
			€1,530,000
Minus: ShPP fikse			- €980,000
Fitimi maksimal neto			€550,000

2 pikë

- b. i. Kthimi në qarkullim për orë të prodhimit të burimit të 'fytit të ngushtë' =
= (çmimi i shitjes - kostoja e materialit) ÷ orët në burim të 'fytit të ngushtë'

Renditja e produkteve në bazë të kthimit në qarkullim për orë të 'fytit të ngushtë'.

	<u>Produkti A</u>	<u>Produkti B</u>	
Çmimi i shitjes	€200	€220	
Kostoja e materialeve	- €12	- €80	
Kthimi në qarkullim	€188	€140	
Orë të 'fytit të ngushtë' për njësi	÷ 0.5	÷ 0.4	
Kthimi për orë të 'fytit të ngushtë'	€376	€350	
Renditja	1	2	2 pikë

Përcaktimi i përzierjes së produkteve për maksimizimin e fitimit

<u>Produkti</u>	<u>Kërkesa</u>	<u>Orët e nevojshme</u>	<u>Orët në dispozicion</u>		<u>Njësi të prodhuara</u>
A	7,500	3,750	3,750	(÷ 0.5)	7,500
B	5,000	<u>2,000</u>	(Balanca) <u>1,750</u>	(÷ 0.4)	4,375
		5,750	5,500		2 pikë

Llogaritja e fitimit maksimal

<u>Produkti</u>	<u>Njësitë</u>	<u>Kontributi për njësi</u>	<u>Fitimi</u>	
A	7,500	× €188	1,410,000	
B	4,375	× €140	<u>612,500</u>	
Kthimi i përgjithshëm në qarkullim			2,022,800	
Minus: Shpenzimet e përgjithshme				
të paraqitura si variabile nën (a) [(6,000 × €58) + (4,000 × €16)]			(412,000)	3 pikë
fikse			<u>(980,000)</u>	
Fitimi maksimal neto			630,500	2 pikë

b. ii. Koeficienti kontabël i qarkullimit = Kthimi në qarkullim për orë ÷ kostot e konvertimit në orë

Kosto të konvertimit në orë = shpenzimet e përgjithshme ÷ orët e fytit të ngushtë

= €(412,000 + 980,000) ÷ 5,500

= €253.09

2 pikë

∴ Koeficienti kontabël i qarkullimit për A = €376 ÷ €253.09 = **1.4856**

1 pikë

∴ Koeficienti kontabël i qarkullimit për B = €350 ÷ €253.09 = **1.3829**

1 pikë

Problemi 3

Kompania Omikron po përgatitë buxhetin e tyre për vitin për tremujorin e dytë të vitit aktual. Bazë për përgatitjen e këtij buxheti është buxheti i tremujorit të dytë të vitit të kaluar nga i cili nuk do të bëjnë asnjë ndryshim, por për shkak kufizimeve në qarkullim dhe zhvillim të operacioneve të shkaktuara nga pandemia do të dëshironin të parashikonin disa mundësi bazuar në vlerësimet si më poshtë:

- Nëse kufizimet do të vazhdojnë të jenë të larta sikur në tremujorin e parë, që mund të klasifikohet si opsioni më i keq i mundshëm atëherë shitjet e buxhetuara do të kufizohen në 9,000 njësi me një çmim të buxhetuar të shitjes prej €58. Kosto e buxhetuar e materialit direkt pritet të jetë €16.00 për njësi, puna direkte €12.00 për njësi dhe ShPP e buxhetuar variabile €15.00 për njësi. ShPP e buxhetuar fikse për tremujorin e dytë sipas këtij skenari do të jetë €20,000.
- Nëse nuk do të ketë kufizime të qarkullimit dhe të zhvillimit të operacioneve, që mund të klasifikohet si opsioni më i mirë i mundshëm, shitjet e buxhetuara do të jenë 15,000 njësi me çmim të buxhetuar të shitjes prej €62 për njësi. Kostoja e buxhetuar e materialit direkt do të jetë €14.00 për njësi, punë direkte €10.00 për njësi dhe ShPP e buxhetuar variabile €13.50 për njësi. ShPP e buxhetuar fikse për tremujorin e dytë sipas këtij skenari do të jetë €15,000.
- Nëse gjatë tremujorit të dytë do të ketë zbutje të kufizimeve të qarkullimit dhe të zhvillimit të operacioneve, që mund të klasifikohet si opsioni me më shumë gjasa që të ndodhë, atëherë shitjet e buxhetuara do të jenë për 3,000 njësi mbi nivelin më të keq të mundshëm me një çmim të buxhetuar të shitjes prej €60 për njësi. Kostoja e buxhetuar e materialit direkt do të jetë €15.00 për njësi, punë direkte €10.50 për njësi dhe ShPP e buxhetuar variabile do të jetë €14.00 për njësi. ShPP e buxhetuar fikse për tremujorin e dytë sipas këtij skenari do të jetë €18,000.
- Ekziston një probabilitet prej 15% që të ndodhë skenari më i keq i mundshëm, një probabilitet prej 20% që të ndodhë skenari më i mirë i mundshëm dhe një probabilitet prej 65% që të ndodhë skenari me më shumë gjasa.

Kërkohet

- Të përgatiten buxhetet e Kompanisë Omikron për tremujorin e dytë të vitit aktual sipas tri skenarëve (më i keq i mundshëm, më i mirë i mundshëm dhe me më shumë gjasa). **9 pikë**
- Të llogaritet vlera e pritur e fitimit neto sipas buxheteve nga kërkesa a. për tremujorin e dytë të vitit aktual. **3 pikë**
- Listoni katër llojet e standardeve dhe shkurtimisht përshkruani secilin prej tyre. **8 pikë**

Zgjidhja

- Përgatitja e buxheteve për tremujorin e dytë të vitit aktual sipas tri skenarëve

Sistemimi i të dhënave

		<i>Çmimi i</i>	<i>Kosto e</i>	<i>Kosto e</i>		<i>Kosto</i>	
	<i>Shitjet</i>	<i>shitjes</i>	<i>MD</i>	<i>PD</i>	<i>ShPP</i>	<i>fikse</i>	<i>Probabiliteti</i>
Më i keq (K)	9,000	58.0	16.0	12.0	15.0	20,000	15%
Më shumë gjasa	12,000	60.0	15.0	10.5	14.0	18,000	65%
Më i mirë (M)	15,000	62.0	14.0	10.0	13.5	15,000	20%

Përqatitja e buxheteve

	<u>më të keq</u>	<u>Buxheti sipas skenarit ...</u> <u>me më shumë gjasa</u>	<u>më të mirë</u>
Njësi	9,000	12,000	15,000
Çmimi i shitjes për njësi	× <u>58.0</u>	× <u>60.0</u>	× <u>62.0</u>
Shitjet	522,000	720,000	930,000
Kosto variabile për njësi	× <u>43.0</u>	× <u>39.5</u>	× <u>37.5</u>
Kosto e ndryshueshme	<u>387,000</u>	<u>474,000</u>	<u>562,500</u>
Kontributi	135,000	246,000	367,500
Kostot fikse	<u>20,000</u>	<u>18,000</u>	<u>15,000</u>
Fitimi (Humbja)	115,000	228,000	352,500

3 × 3 = 9 pikë

b. Llogaritja e vlerës së pritur të fitimit neto

Skenari	<u>Fitimi/Humbja</u>	<u>Probabiliteti</u>	<u>Vlera e pritur</u>	
Më i keq	115,000	15%	17,250	
Me më shumë gjasë	228,000	65%	148,200	
Më i mirë	352,500	20%	<u>70,500</u>	
	Vlera e pritur e fitimit neto		235,950	3 pikë

c. Llojet e standardeve

Standardi ideal - është një standard që mund të arrihet në kushte të përsosura të operacioneve: asnjë humbje, nuk ka jo-efikasitet, nuk ka kohë boshe, nuk ka prishje (dështime).

Standardi i arritshëm - është një standard që mund të arrihet në qoftë se prodhimtaria është kryer në mënyrë efikase, makina kanë operuar si duhet dhe/ose materialet janë përdorur si duhet. Disa lejime janë bërë për humbje (mbeturina të materialeve) dhe për punë boshe (jo-efikasitet).

Standardi aktual - është standardi i bazuar në kushtet aktuale të punës (duke marrë parasysh humbjet aktuale, jo-efikasitetin aktual)

Standardi bazik - është një standard afat-gjatë i cili mbetet i pandryshuar gjatë viteve dhe është përdorur për të treguar trendët.

4 × 2 = 8 pikë

Problemi 4

- a. Kostoja e përgjithshme mesatare e një autobusi të linjës 3 të Trafikut Urban për karburant, mirëmbajtje dhe paga të personelit, gjatë vitit të kaluar është në vlerën prej €70,000. Gjatë kësaj kohe mesatarja e punës së bërë ka qenë 5,600 orë pune. Input-et e paraqitura kanë rezultuar këto output-e: janë bërë mesatarisht 56,000 kilometra dhe numri mesatarë i xhirove të qarkulluara në relacionin e përcaktuar është 2,800 xhiro.

Kërkohet

- i. Bazuar në informatat e input-eve dhe output-eve të dhëna të llogariten të gjitha masat e mundshme kuptimplota të performancës. Ndihmë: janë gjithsej 12 masa (secili indikator në raport me tre tjerët). **6 pikë**
- ii. Për secilën masë të performancës së llogaritur në kërkesën a. të shpjegohet se çfarë paraqet ajo masë. **6 pikë**
- b. Një nga kompetencat për të përmbushur objektivat e performancës është grumbullimi dhe sistemimi i të dhënave nga sistemet e të dhënave. Këto të dhëna formojnë raporte për menaxhment dhe janë çelësi për kontrollin dhe mbikëqyrjen e performancës. Andaj, është e domosdoshme që të merren në konsideratë burimet e të dhënave dhe procedurat që mund të jenë të nevojshme për të garantuar sigurinë e të dhënave me besueshmëri të lartë.
- Organizatrat mund t'i marrin dhe përdorin të dhënat nga burimet e brendshme dhe nga burimet e jashtme.
- Burimet e brendshme të të dhënave përfshijnë të dhënat e kontabilitetit financiar dhe sistemeve të tjera të lidhura ngushtë me sistemin e kontabilitetit dhe mund të klasifikohen si burime të të dhënave monetare dhe jo-monetare. Marrja (zotërimi) i të dhënave përbrenda organizatës përfshinë sistemin për mbledhjen dhe matjen e të dhënave, komunikimin formal dhe jo-formal të të dhënave në mes të menaxherëve dhe personelit etj.

Kërkohet

1. Identifikoni katër burime të të dhënave të brendshme dhe për secilin burim të identifikuar paraqiteni nga dy të dhëna duke përcaktuar nëse ato të dhëna janë monetare apo jo-monetare.

8 pikë

Zgjidhja

- a. i. Llogaritja e masave kuptimplota të performancës

		<i>Kosto</i>	<i>Orë</i>	<i>Kilometra</i>	<i>Xhiro</i>
		<u>70,000</u>	<u>5,600</u>	<u>56,000</u>	<u>2,800</u>
<i>Kosto</i>	<u>70,000</u>		12.50 ¹	1.25 ²	25.00 ³
<i>Orë</i>	<u>5,600</u>	0.08 ⁴		0.10 ⁵	2.00 ⁶
<i>Kilometra</i>	<u>56,000</u>	0.80 ⁷	10.00 ⁸		20.00 ⁹
<i>Xhiro</i>	<u>2,800</u>	0.04 ¹⁰	0.50 ¹¹	0.05 ¹²	

12 × 0.5 = 6 pikë

a.ii. Shpjegimi i masës së performancës

1	$€70,000 \div 5,600^h = €12.50^h$	Kosto prej €12.50 është shkaktuar për 1 orë të punës
2	$€70,000 \div 56,000 \text{ km} = €1.25 \text{ për km}$	Kosto prej €1.25 është shkaktuar për 1 kilometër të kaluar
3	$€70,000 \div 2,800 \text{ xhiro} = €25 \text{ për xhiro}$	Kosto prej €25 është shkaktuar për 1 xhiro të qarkulluar
4	$5,600^h \div €70,000 = 0.08^h \text{ për €1 kosto}$	Për çdo 0.08 ^h (4.8 min.) është shkaktuar nga €1.00 kosto
5	$5,600^h \div 56,000 \text{ km} = 0.10^h \text{ për 1 km}$	Për çdo 0.10 ^h (6.0 min.) është kaluar rruga prej një kilometri
6	$5,600^h \div 2,800 \text{ xhiro} = 2^h \text{ për 1 xhiro}$	Për çdo 2 ^h është kaluar një xhiro e plotë
7	$56,000 \text{ km} \div €70,000 = 0.80 \text{ km për €1 kosto}$	Për çdo 0.80 km (800 metra) është shkaktuar nga €1.00 kosto
8	$56,000 \text{ km} \div 5,600^h = 10 \text{ km për } 1^h$	Për të kaluar rrugën prej 10 kilometrave është nevojitur 1 ^h kohë
9	$56,000 \text{ km} \div 2,800 \text{ xhiro} = 20 \text{ km për 1 xhiro}$	20 kilometra rrugë janë kaluar për të bërë një xhiro të plotë
10	$2,800 \text{ xhiro} \div €70,000 = 0.04 \text{ e xhiros për €1 kosto}$	Për çdo 0.04 pjesë të xhiros (1/25 të xhiros) është shkaktuar nga €1.00 kosto
11	$2,800 \text{ xhiro} \div 5,600^h = 0.50 \text{ e xhiros për } 1^h$	Për çdo 0.50 pjesë të xhiros (1/2 e xhiros) është nevojitur 1 ^h
12	$2,800 \text{ xhiro} \div 56,000 \text{ km} = 0.05 \text{ e xhiros për 1 km}$	Për çdo 0.05 pjesë të xhiros (1/20 e xhiros) është rruga prej 1 km

12 × 0.5 = 6 pikë

b. i. Burimet e të dhënave të brendshme

	<u>Burimi</u>	<u>Lloji i të dhënës</u>	<u>E dhënë ...</u>
1	Regjistrat/regjistrimet e kontabilitetit financiar (libri kryesor, libri i shitjes, i blerjes, libri i arkës)	- të dhënat mbi shitjet ditore - numrat e çeqeve	monetare jo-monetare
2	Burimet njerëzore	- numri i punëtorëve - paga mujore e secilit punëtorë	jo-monetare monetare
3	Departamenti i prodhimitarisë	- kapaciteti i makinerisë - sasia e lëndës së parë të përdorur	jo-monetare jo-monetare
4	Departamenti i blerjes	- numri i porosive të blerjes - dëftesat për mallrat e pranuar	jo-monetare jo-monetare

4 × 2 = 8 pikë

Problemi 5

Kompania 'Pixel' bënë prodhimin e monitorëve të kompjuterëve. Lloji i monitorëve të prodhimitarisë ekzistuese është i formatit 4:3 të madhësisë deri në 22'' (inch). Kompania është duke shqyrtuar mundësinë për zgjerimin e prodhimitarisë me prodhimin e monitorëve të formatit 16:9 të madhësisë deri në 27'' (inch). Për këtë qëllim janë bërë vlerësimet e mëposhtme:

Numri (vjetor) i njërive	22,500 njësi
Vlera e parashikuar e shitjeve	€6,637,500
Kostot mesatare variabile për njësi	€175.00
Kostot e përgjithshme fikse	€1,925,000

Kërkohet:

- Llogaritni, bazuar në të dhënat e mësipërme se çfarë vendimi duhet të merr menaxhmenti i kompanisë lidhur me zgjerimin e veprimtarisë dhe pse. **2 pikë**
- Përkufizoni se çfarë është analiza e ndjeshmërisë. Cilat janë tri qasjet e dobishme të analizës së ndjeshmërisë? **6 pikë**
- Analizoni ndjeshmërinë e mundësisë për zgjerimin e veprimtarisë ndaj ndryshimeve në variablat kryesore (të hyrave nga shitjet, vëllimit të shitjeve (kontributit), kostos variabile për njësi dhe kostove të përgjithshme fikse) dhe komentoni rezultatet e fituara. Cila është variabla më e ndjeshme dhe pse? **12 pikë**

Zgjidhja

- Llogaritja e profitabilitetit e zgjerimit të veprimtarisë bazuar në vlerësimet e bëra:

Të hyrat nga shitja (të vlerësuara)	€6,637,500
Kostot e përgjithshme variabile (22,500 njësi × €175)	€3,937,500
<i>Kontributi</i>	€2,700,000
Kostot e përgjithshme fikse	€1,925,000
Fitimi nga zgjerimi i veprimtarisë (i vlerësuar)	€775,000

Bazuar në vlerësimet e bëra - projekti i zgjerimit të veprimtarisë është i arsyeshëm sepse sjell fitim vjetor në vlerë prej €775,000. **2 pikë**

- Përkufizimi i analizës së ndjeshmërisë dhe qasjet e dobishme të saj

- **Analiza e ndjeshmërisë** - është një term i përdorur për të përshkruar teknikën përmes së cilës alternativat e vendimit testohen për lëndueshmërinë e tyre ndaj ndryshimeve në cilëndo 'variabël' (si p.sh vëllimi i pritshëm i shitjes, çmimi i shitjes për njësi, kostot e materialeve, kostot e punës etj.) dhe matë efektin e ndryshimeve në vlerën e parashikuar të një elementi ('faktori kyç') në rezultatit e ardhshëm. **1½ pikë**
- **Tri qasjet** e dobishme për analizën e ndjeshmërisë janë:
 - Për të vlerësuar se **për çfarë vlere kostot dhe të hyrat do të duhet të ndryshojnë** nga vlerat e tyre të vlerësuara përpara se vendimi të ndryshojë. **1½ pikë**
 - Për të vlerësuar se a do të ndryshojë një vendim në qoftë se kostot e vlerësuara janë për **X% më të larta** se ato të vlerësuara, ose të hyrat e parashikuara për **Y% më të ulëta** se ato të vlerësuara. **1½ pikë**
 - Për të vlerësuar se për çfarë vlerë kostot dhe/ose të hyrat do të duhet të ndryshojnë nga vlerat e tyre të vlerësuara para se vendimmarrësi do të jetë **mospërfillës/indiferent** në mes dy alternativave. **1½ pikë**

c. Analizimi i ndjeshmërisë së mundësisë për zgjerimin e veprimtarisë ndaj ndryshimeve në variablat kryesore

– Të hyrat nga shitja

$$\begin{aligned}\text{Raporti fitim/shitjet} &= \text{Fitimi} \div \text{Të hyrat nga shitja} \\ &= €775,000 \div €6,637,500 \\ &= \mathbf{11.68\%}\end{aligned}$$

Projekti i zgjerimit të veprimtarisë do të bëhet jo-profitabil në qoftë se të hyrat nga shitja do të zvogëlohen për më shumë se 11.68% nga shitjet e vlerësuara. Me zvogëlimin e shitjeve mbi 11.68% projekti do të gjeneroi humbje. **2½ pikë**

– Vëllimi i shitjeve (kontributi)

$$\begin{aligned}\text{Raporti fitim/kontribut} &= \text{Fitimi} \div \text{Kontributi} \\ &= €775,000 \div €2,700,000 \\ &= \mathbf{28.70\%}\end{aligned}$$

Nëse vlera e kontributit do të zvogëlohet për më shumë se 28.70% krahasuar me nivelin e vlerës së kontributit të vlerësuar projekti do të filloi të gjeneroi humbje. **2½ pikë**

– Kostoja e përgjithshme variabile

$$\begin{aligned}\text{Raporti fitim/kosto e përgjithshme variabile} &= \text{fitimi} \div \text{kosto e përgjithshme variabile} \\ &= €775,000 \div €3,937,500 \\ &= \mathbf{19.68\%}\end{aligned}$$

Nëse kostot e përgjithshme variabile do të rriteshin me më shumë se 19.68% nga vlera aktuale e vlerësuar atëherë projekti për zgjerimin e veprimtarisë do të bëhet jo-profitabil dhe do të gjeneroi humbje. **2½ pikë**

– Kostoja e përgjithshme fikse

$$\begin{aligned}\text{Raporti fitim/kosto e përgjithshme fikse} &= \text{fitimi} \div \text{kosto e përgjithshme fikse} \\ &= €775,000 \div €1,925,000 \\ &= \mathbf{40.26\%}\end{aligned}$$

Nëse kostot e përgjithshme fikse do të rriten për më shumë se 40.26% nga vlera e kostove të përgjithshme të vlerësuara fikse atëherë projekti do të gjeneroi humbje **2½ pikë**

– Në analizën e ndjeshmërisë, rezultati me përqindjen më të ultë e identifikon variablën me kritike (të lëndueshme), në këtë rast rezultati me përqindjen më të ultë është 11.68% që i identifikon të hyrat nga shitja respektivisht përbërësit e të hyrave nga shitjet (çmimin e shitjes dhe numrin e njësive të shitura) variablën të cilës duhet kushtuar kujdes të shtuar pasi që çdo zvogëlim (shikuar veç e veç) i çmimit të shitjes apo numrit të njësive të shitura mbi 11.68% do të bëjë që kompania të gjeneroi humbje. Gjithashtu duhet përcjellë me kujdes edhe zvogëlimin e kombinuar të çmimit të shitjes dhe numrit të njësive të shitura që mund të shkaktoi zvogëlimin e të hyrave nga shitja mbi 11.68% që do të ndikoi që projekti të bëhet jo-profitabil. **2 pikë**